

HYLLI I D R I T Ë S

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.
(II. ad Cor. III. 17).

V O T E R
K U L T U R E
S H O Y P T A R E

11-12

Nanduer-Dhetuer 1939-XVIII.
— V J E T I X V . —
S H K O D E R

Abonimi per „HYLLI I DRITËS“

Shqypni	Nji numer Fr. a. 0.80	Nji vjetë Fr. a. 7.—
Itali	„ „ „ „ 0.80	„ „ „ „ 7.—
Nder Vende tjera . .	„ „ „ „ 1.20	„ „ „ „ 10.—

Administratori: A. B. Dema

HYLLI I DRITËS

PERMBAJTJA

Kushtrimi i zëmres P. F. CORDIGNANO, S. J.	fq. 505
Vasha n'epopën kombtare të popullit shqyptar: Tringa e Malcis	» 518
GJIKAM	
Nji „28 Nanduer“ gjaku (1926)	» 539
E. ÇABEJ	
Shqiptarët n'Itali të mesme dhe në Napoli	» 542
Prof. FRANO ALKAJ	
Iliada e Homerit (Libri XXIV)	» 547
SPIRO KONDA	
Apologjija e Sokratit	» 553
GELASIUS	
Fjalori toponomastik: Emna vendesh	» 565
GJETO KOLA	
Himara	» 574
P. D. KURTI	
Filiske - Fiskama (rapsodi)	» 586
BARDHYLI	
Historija e Bibliotekavet në Shqiprië: Bibliotekat e Bibliotektarët	» 600
L. ÇIURÇIJA	
Lotarija (novelë)	» 604
P. M. SIRDANI	
Dita e Flamurit	» 611
A. D. KURTI	
Prralla - Fash. 19, 20	145-160

KUSHTRIMI I ZËMRES

Që me luften botnore, jetës së shkrueme dér atëherë i u vû një vizë: me ndrrimin e kartës gjeografike, ndrroi edhe diplomacia e politika; me perparimin teknik e me zhvillimin e perftimin industrjal, në gjí të familjeve e të popujve kjenë krijue rrethana e nevojë të reja me randsí të parë per jetë; marrdhanjet ekonomike, financjare e shoqnore mueren fare më të ré. Disi pá u kujtue, nder të gjitha rrangët nisi me u dallue koha para lufte e koha mbas lufte.

Ky ndrrim i fórt pershíni jo vetem rrethet e dukës e tfaqjen e jetës, por depertoí mje në shpírt e në mentalitet: që m' at kohë xún të ndrrojné edhe kriteret e vlerët, mbas së cillave andej e para u peshote e u çmote vepra nierzore, si vehtjake ashtu botnore. Jeta, në tanë kuptimin e vet, kje shikjue me sý tjerë. Europa dajti si e vjetrueme, si të duete me u pertrí krejt më të ré materjalisht e shpirtnisht.

Strofulli u prish. Mentaliteti i perparshem e pat. Orientime tjera muer mendimi e puna; filozofija disi u smbrap; vendin e logjikës u mbat t' a xájë fakti dinamik; udhëhjeksat shoqnorë u bânë edhe prísat e mendimit botnuer. S' u la gúr pá u luejtë as mjet pá u perdorue per me e gjetë vizen e me e vendue at *Charta magna*, parimin e sistemin, mbí të cillin do të pshtetej e sugurtë jeta e popujve n' Europë.

Kje kush e quejti ket nderkohë, porsí urë kalimi e pregatitjeje të njëj epokës së ré, qi do t' agojë në botë.

Kaluen tash mâ se 20 vjet nder këto rropame, e Europa e bota dán se ásht aty se aty: në kerkesen e fijos së lamshit të jetës moderne. Jemi në regrès a por në perparim? S' ká dyshim se kjenë bâ hapa edhe me randsí në zhvillimin e jetës nierzore, por veç as çpikjet (invencjonet), as rropamet

